



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:035831

Datë: 29.04.2024

Numri i dokumentit: 05631578

KPPP.nr.57/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., me NUI: 70465104, me seli në Mitrovicë, rruga "Vëllezërit Dragaj", p.n., kundër debitorit "Proex" SH.P.K., me NUI: 810806862, me seli në Prishtinë, rruga "Fehmi Lladrovci" nr.32, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.4056/20 të datës 23.10.2020, të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa me seli në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 29.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit "Proex" SH.P.K. dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.4056/20 i datës 23.10.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, për pjesën sa i përket detyrimit kryesor në shumën prej 1,075.21€ (një mijë e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzet e një cent).
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.4056/20 i datës 23.10.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbartimore.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A., ndaj debitorit "Proex" SH.P.K., sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.4056/20 të datës 23.10.2020, për detyrimin kryesor në shumën prej 1,075.21€ (një mijë e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzet e një cent).

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “UNITETI” SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.4056/20 të datës 23.10.2020, me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm – Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist Nr. MI.8.B.201235 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbartshjes së obligimeve të papaguara nga Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin t’ia paguajë kreditorit shumën prej 1,075.21 €, me kamatëvonesë prej 8%, duke llogaritur nga data e paraqitjes së propozimit e deri te pagesa definitive, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, dhe të gjitha këto detyrime të realizohen përmes zbatimit të përmbartimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të kreditorit, dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përmbartimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar se nuk ka proces të barazimit në mes të kreditorit dhe debitorit, borxhi i kërkuar nga debitori është i njëanshëm, i njëjti pasqyron vetëm kartelat e kreditorit dhe jo faturat e konfirmuara të cilat do të duhej të ishin të nënshkruara dhe vulosura nga palët. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit, të refuzohet urdhri përmbartimor, si dhe të obligohet kreditori që debitorit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka theksuar se debitori ka paguar fatura për muaj të ndryshëm brenda viteve për të cilat ka pranuar shërbime nga kreditori, ndërsa shuma e kërkuar sipas propozimit për përmbartim është borxhi që ka debitori ndaj kreditorit për shërbimet ndër vite. Tutje ka shtuar se procedura përmbartimore mund të fillohet në bazë të dokumentit të besueshëm si faturat apo ekstraktet e verifikuara në të cilat pasqyrohen pagesat dhe detyrimet që ka debitori ndaj kreditorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, me aktvendimin PPP.nr.1003/2020, të datës 20.04.2021, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër

urdhrit përbarimor P.nr.4056/20 të datës 23.10.2020, të lëshuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa.

Debitori me datë 11.05.2021, ka paraqitur ankesë për shkak se debitori ka përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, duke i propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Dytë, me Aktvendimin K.DH.SH.II.nr.241/23 të datës 29.12.2023, ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit, ka prishur aktvendimin e atakuar dhe çështja i është kthyer Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, vërejtjeve sipas aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi është pjesërisht i bazuar për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se borxhi i kërkuar nga kreditori me propozimin për përbarim dhe i lejuar me urdhrin e Përmbaruesit Privat Atip Mustafa, P.nr.4056/20 të datës 23.10.2020, në shumën prej 1,075.21 €, është përmbushur në tërësi.

Gjykata duke u bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht nga dëshmia e pagesës e datës 28.04.2021, e konfirmuar nga ProCredit Bank me datë 28.04.2021, vërtetohet fakti se debitori ka përmbushur në tërësi borxhin ndaj kreditorit sipas ekstraktit të verifikuar, i cili është objekt i kësaj procedure përbarimore dhe atë shumën prej 1,075.21 €, andaj vlerësoi se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe duke u mbështetur në nenin 71 par.1 nën par.1.2, të LPP-së, me të cilin përcaktohet se *“dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues është prishur anuluar, ndryshuar ose shfuqizuar në një mënyrë tjetër, gjegjësisht nëse në ndonjë mënyrë e ka humbur efektin e tij ose është konkluduar se është pa efekt juridik”*, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, pasi që ekstrakti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përbarimor, e ka humbur efektin juridik, sepse borxhi sipas ekstraktit është përmbushur nga ana e debitorit.

Gjykata në kuptim të nenit 4 paragrafit 4 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, në të cilën theksohet se *“përveç tarifës së efikasitetit të përmbartimit, e cila përcaktohet me marrëveshje në mes të përmbartuesit privat dhe kreditorit, tarifata tjera paraprakisht paguhen nga kreditorit dhe pas përfundimit të procedurës, ato i ngarkohen debitorit”*, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, meqenëse kreditori i ka kërkuar edhe shpenzimet e procedurës përmbartimore që janë krijuar prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi, i cili është lejuar me urdhrin përmbartimor të Përmbartuesit Privat Atip Mustafa, P.nr.4056/20 të datës 23.10.2020. Andaj gjykata vlerësoi se shpenzimet e përmbartimit janë krijuar nga ana e debitorit, pasi që i njëjti detyrimin e tij ndaj kreditorit e ka përmbushur pas inicimit të procedurës përmbartimore dhe zhvillimit të procedurës deri në këtë fazë.

Andaj nisur nga fakti se në rastin konkret debitori e ka paguar në tërësi detyrimin e tij ndaj kreditorit, si dhe duke u bazuar në nenin 66 paragrafin 4 të LPP-së i cili përcakton se: *“Pas përmbushjes së kredisë së kreditorit nxirret vendimi për përfundimin e procedurës përmbartimore”*, dhe nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit si rrjedhojë e përmbushjes në tërësi të kredisë në të holla të palës kreditore, ndërsa urdhrin përmbartimor e la në fuqi, vetëm sa i përket pjesës së shpenzimeve të procedurës përmbartimore.

Gjykata në kuptim të nenit 66 par. 4, nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 4 par. 4, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.57/24, datë 29.04.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.